

Broshura me planet e Serbisë për Kosovën

Tetor 2006

Zonat e Veçanta në funksion të rikolonizimit të Kosovës dhe serbizimit të kulturës e historisë sonë

Dy procese nëpërmjet të cilave shteti serb po synon legalizimin e pranisë së strukturave të tij brenda vendit tonë janë decentralizimi dhe krijimi i zonave me status të veçantë për kishat dhe manastiret ortodokse të cilat padrejtësisht dhe me dashakeqësi po quhen serbe. Në rajonet e enklavizuara të Kosovës, shtrirja e kontrollit territorial të Serbisë po realizohet nëpërmjet decentralizimit. Kurse, aty ku serbët janë një pakicë e thjeshtë, Serbia po synon ta arrijë rikolonizimin e Kosovës nëpërmjet planifikimit demografik, duke i keqpërdorur institucionet fetare. Decentralizimi do t'ia mundësojë Serbisë ushtrimin e kontrollit në më shumë se 15% të territorit të Kosovës (prej rajonit të Anamoravës e deri në Graçanicë), plus 18.9% të territorit që shteti serb ka në veriun e Kosovës, ku funksionon çdo strukturë institucionale e këtij shteti. Por, apetitet e Serbisë për shtënien në dorë të më shumë territoreve nuk po përfundojnë me kaq, ashtu siç nuk kanë rreshtur asnjëherë përgjatë historisë. Procesi tjetër plotësues me atë të decentralizimit është krijimi i Zonave të Veçanta përreth objekteve të besimit. Sipas planeve të qeverisë serbe, statusin e zonave të veçanta mbrojtëse do ta fitojnë gjithsej 150 objekte kulturi, 21 prej të cilave Serbia i quan të një 'rëndësie strategjike' (shih foton 8). Kjo hapësirë përfshin gjithsej rreth 1.000 km², apo 9,2% të territorit të Kosovës.

Nëpërmjet krijimit të Zonave të Veçanta Serbia po synon uzurpimin e historisë dhe kulturës sonë. Grupi Negociator i Kosovës ka pranuar që kishat ortodokse në Kosovë të quhen serbe. Pra, ata ia dhuruan Serbisë vlerat kulturore dhe historike të Kosovës dhe tashmë kanë pranuar edhe vendosjen e zonave kinsebrojtëse qindrahektarëshe përreth 39 kishave e manastireve ortodokse që do të serbizohen duke krijuar kështu edhe një mit të ri serb për Kosovën. Uzurpimi i tokës që bëhet nga Zonat e Veçanta paraqet të keqen më të vogël. Të keqen e madhe me pasoja edhe më afatgjate se decentralizimi këto zona e bëjnë meqë uzurpojnë dhe thetërojnë kulturën dhe historinë e Kosovës me qëllim të delegitimimit të autoktonisë së shqiptarëve dhe më pas të paraqitjes së tyre si ardhacakë.

Pas 'eksterritorialitetit' të objekteve kulturore, Serbia do të thotë se xhamitë janë të turqve, kishat e manastiret ortodokse janë të serbëve, ndërkohë që nuk ka objekte fetare e kulturore të shqiptarëve, duke qenë se ata as që ishin në këto troje!

Elita politike dhe intelektuale serbe, qysh në shekullin XIX pat lansuar tezën për shqiptarët si popull i ultë dhe primitiv që s'ka kulturë. Rrjedhimisht, kjo tezë i paraqiste serbët si superiorë që duhet të sundojnë e qeverisin me shqiptarët e paditur e të paaftë. Teza e këtillë atëbotë përputhej me kolonializmin e fuqive të mëdha botërore që shtypnin popujt e Botës së Tretë dhe shfrytëzonin pasuritë e tyre. Sot, meqë kjo tezë është raciste dhe realisht e papërdorshme, establishmenti serb vuri në lëvizje tezën rezervë për shqiptarët e Kosovës si popull mbeturinë e Perandorisë Osmane ose ardhacakë nga Shqipëria, të cilët në rastin më të mirë na paskan ardhur në Kosovë pas të ashtuquajturës dyndje e madhe serbe të vitit 1690, atëherë kur nga Kosova dhe jo vetëm ajo u tërhoq Perandoria Austro-Hungareze për t'ia lënë vendin në këto treva sërish Perandorisë Osmane. Bazuar në këtë tezë, kultura e Kosovës nuk është e shqiptarëve të Kosovës. Natyrisht se në të dy variantet bëhet fjalë për falsifikim të historisë që mëton të justifikojë planet politike të Serbisë për sundimin e Kosovës dhe dëbimin e shqiptarëve. Kanë ndryshuar politikanët, por jo edhe politika serbe. Kanë ndryshuar tezat serbe, por jo edhe motivi e qëllimi i tyre. Do të thonë se, në rastin më të mirë, sipas tyre shqiptarët në Kosovë kanë ardhur pas të ashtuquajturës dyndje të madhe serbe të prirë nga prifti Çarnojeviq në fund të shekullit XVII! Pra, kësisoj ata po e përgatisin motivin edhe për agresionin e ri serb mbi Kosovën që synon t'i dëbojë edhe njëherë dhunshëm shqiptarët në një moment të volitshëm për Serbinë në të ardhmen. Luftërat në Kosovë përgjatë shekullit XX ishin luftëra të popullit të shtypur shqiptar të Kosovës dhe jo vetëm të tij, kundër Serbisë që ushtronte gjenocid e terror. Decentralizimi përfundimisht po e shndërron luftën e tillë në konflikt etnik shqiptaro-serb, ndërkaj 'eksterritorialiteti' i trashëgimisë kulturore po e shpien edhe një hap më tutje: po e përgatit fuqishëm terrenin për konflikt fetar i cili asnjëherë s'ishte karakteristikë e kryengritjeve dhe rezistencave të shqiptarëve nëpër shekuj. Në shumë aspekte, kësisoj, Kosova po e përsërit historinë e Irlandës së Veriut. Winston Churchill, sigurisht pa e kursyer cinizmin e tij sa zbatimës aq edhe disi të pështirë, me një rast pat thënë se në qoftë se doni që një konflikt të mos përfundojë kurrë, atëherë,

VETËVENDOSJE !

zhvendoseni atë në terrenin fetar. Përderisa decentralizimi e tjetëron konfliktin, 'eksterritorialiteti' e përjetëson atë. Këta negociatorë kosovar, Koshtunicës po ia plotësojnë ëndrrën për Kosovën si 'Jerusalem serb', për shndërrimin e Kosovës në fushëbetejë të amshueshme në të cilën, për më keq se kaq, kërkesa mitike dhe hegjemoniste serbe fiton legjitimitet. Duke i negociuar vlerat kulturore e historike dhe rregullimin e brendshëm territorial të Kosovës me armikun e saj Serbinë dhe para se Kosova të jetë sovraane, negociatorët kosovar Koshtunicës e Tadiqit po ua realizojnë ëndrrën e akademisë famëkeqe të shkencave dhe arteve të Serbisë për serbizimin gradual por të sigurt të Kosovës dhe të historisë së saj. Fotot 9, 10, 11 dhe 12 tregojnë shumë qartë që këto objekte të besimit nuk janë serbe, por ortodokse. Në këto objekte janë lutur edhe shqiptarët. Disa prej tyre edhe janë ndërtuar prej shqiptarëve.

Ky proces i dëmshëm filloi me Manastirin e Deçanit. Më 1997 qeveria e Slobodan Milosheviqit i dha këtij Manastiri status 'eksterritorial' në 23 hektarë të hapësirës ku ai ndodhet. Kurse, në vitin 2000, ish Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Bernard Kouchneri, me vendimin ekzekutiv nr. 2000/3 e liroi Manastirin e Deçanit nga juridiksioni, autoriteti komunal, regional dhe ai qendror. Me këtë vendim UNMIK-u rilegalizoi vendimin e qeverisë së Milosheviqit të vitit 1997. Ky është edhe një tjetër fakt qysh UNMIK-u, duke e njohur zyrtarisht sovranitetin nominal të Serbisë mbi Kosovën, i lejon asaj ndërhyrjen në çështje të ndryshme brenda vendit tonë, prej rregullimit të pushtetit lokal e deri te krijimi i këtyre zonave me status të veçantë, të cilat nuk do t'i përgjigjen askujt tjetër përveç Beogradit.

Në janar të vitit 2003, qeveria e Unionit Serbi dhe Mal i Zi ia paraqiti Organizatës për Edukim, Shkencë dhe Organizim Kulturor (UNESCO) planin e saj për Manastirin e Deçanit. Projekti i Serbisë u pranua. Ndërkaq, vjet, PSSP-ja i atëbotshëm, Soren Jessen-Petersen me vendimin ekzekutiv nr. 2005/5, i cili hyri në fuqi më 25 prill të vitit 2005, i jep statusin e Zonës së Veçantë Mbrojtëse 866 hektarëve përreth vendit ku ndodhet Manastiri. Territori që i është dhënë Manastirit në bazë të vendimit të lartëcekur është si vijon: përfshin një gjerësi në të dy anët e kreshtave, që është mbi 7 km (1 km përtej 'Urës së Gjashtëshit'), e që i bjen diku te Rruga për Bjeshkët e Bellesë (shih foton 13). Trafiku komercial me kamion të rëndë nuk do të

lejohej pa lejen e KFOR-it, ose të UNMIK-ut. Po ashtu, të gjitha rrugët komunale, regjionale dhe autostradat duhet që të përshtaten më plotësisht me kërkesën të dalur nga statusi i veçantë i rajonit në fjalë.

75% të tokave brenda kësaj hapësire janë prona private të fshatarëve shqiptar. 200 hektarë janë pronë e ndërmarrjeve publike e shoqërore si ajo e prodhimit të ujit mineral 'GUSHAVCI' dhe ajo e gurit të mermerit, pastaj ndërmarrja bletare 'APIKO', ajo hoteliere 'ILIRIA', pushimorja e fëmijëve, pushimorja e punëtorëve të ndërmarrjes 'EMIN DURAKU', autoriteti pyjor 'GJERAVICA' dhe hidrosistemi 'BISTRICA'. Vendimit ekzekutiv nr. 2005/5 i paraprin edhe një letër e ish zëvendëskryedrektorit, Charles Bryshaw, në vitin 2003, të cilën e mori për bazë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) për të mos privatizuar asnjë nga ndërmarrjet publike që gjenden në tokën që i është dhënë Manastirit. Kjo është një goditje serioze për ekonominë e kësaj komune. Edhe ashtu komuna e Deçanit është njëra prej pjesëve më të pazhvilluara ekonomikisht dhe me shkallën më të lartë të papunësisë në Kosovë. Papunësia në këtë komunë arrin shifrën prej 70%. Fshatarëve u është mohuar kategorikisht mundësia e shfrytëzimit të pronave të tyre, qoftë edhe për nevojat më elementare. Deri tash tre fshatarë janë arrestuar nga KFOR-i italian - njëri duke prerë drunj në pyllin e tij, tjetri duke marrë zhavor nga toka që është pronë e vetja, ndërkaq, i treti vetëm pse ka prerë trungun e kumbullës në pronën e tij. Në këtë zonë është bllokuar çdo aktivitet. Bile është ndërprerë edhe ndërtimi i rrugës që e lidh këtë pjesë me rajonin e Plavës, arterie e rëndësishme qarkullimi për dy vendet. Në pikat që paraqesin kufijtë e tokës që i është dhënë Manastirit, KFOR-i ka vendosur postblloqe. Para disa muajsh aty ndaloheshin dhe maltretoheshin qytetarët që qarkullonin. Pas protestës dyditore të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, me ç'rast për dy ditë radhazi u bllokua ndërtesa e UNMIK-ut në Deçan, kalohet lirisht andejpari, ndonëse postblloku ende mbetet aty.

Politika ekspansioniste e shtetit serb përgjatë historisë ka qenë ndërtuar mbi tri shtylla - kisha, ushtria dhe akademika. Kisha ka bekuar, ushtria ka pushtuar, politika akademike ka planifikuar kolonizimin. Sot, shteti serb po synon që objektet fetare ortodokse në vendin tonë t'i shndërrojë në mjete për rikolonizimin e Kosovës. Në ato hapësira ku këtyre kishave dhe manastireve do t'u sigurohet statusi 'eksterritorial', qeveria serbe po synon

VETËVENDOSJE !

realizimin e të ashtuquajturit 'kthim i qëndrueshëm' i serbëve në Kosovë. Beogradi nuk po dëshiron t'i kthejë serbët aty ku ata kanë qenë, sepse kështu ata do të mbeteshin një pakicë e thjeshtë e shpërndarë në pjesë të ndryshme të Kosovës, pa ndikim fundamental në të ardhmen e Kosovës. Në mënyrë që ata ta kenë ndikimin e tyre aq sa ta mbajnë Kosovën peng, po duan që të vendosen aty ku veç janë shumicë në krahë me shqiptarët, aty ku përmes kthimit bëhen shumicë, atje ku ndërlihin vendbanimet me shumicë serbe, ose atje ku krijojnë vendbanime serbe të përqendruara dhe etnikisht të pastra. Kjo e fundit po synohet të realizohet pikërisht në Manastirin e Deçanit. Në hapësirën e tokës përreth Manastirit Serbia ka plan të ndërtojë një fshat serb. Sipas zyrtarëve nga Ujësllësi i Deçanit, 1/3 e ujit që kalon nëpër këtë ujësllë është paraparë për këtë Manastir. Kurse në këtë Manastir aktualisht jetojnë vetëm 40 klerikë! Te harta 8 mund të shihet se Serbia disa manastire i konsideron si përmendore të kulturës së Serbisë në Kosovë, e që janë me 'rëndësi strategjike'. Pra, për Serbinë ka kulturë strategjike dhe jostrategjike! Natyrisht, varësisht se sa vendndodhja e këtyre objekteve përputhet me planet e saj politike. Rreziku që përfaqëson ky projekt rritet shumëfish kur dihet se vetëm 15 km në veri të Manastirit gjendet Patrikana e Pejës. Nëpërmjet krijimit të këtyre zonave Serbia synon të krijojë lidhje ndërmjet tyre, pra, vazhdimësi territoriale. Prandaj, nëse procesi i decentralizimit luftohet dhe ndalet në radhë të parë në Cernicë, 'eksterritorialiteti' duhet të ndalet pikërisht në Manastirin e Deçanit. Këtu konsiston kuptimi i angazhimit tonë posaçërisht në Sernicë e Deçan.

Arsyetimet e negociatorëve të Kosovës janë të mjerushme dhe bile fyese për popullin e varfër të Kosovës. Veton Surroi pat thënë që 860 hektarë për Kosovën nuk janë asgjë! Në prill të këtij viti, kur e pat vizituar Manastirin e Deçanit, ai pat deklaruar që zonat përreth manastireve janë të nevojshme në mënyrë që shqiptarët të mos ndërtojnë qebaptore andejpari dhe asisoj të mbrohet ambienti rreth tyre! Graçanica vlon prej qebaptoreve që ndodhen brenda zonës së veçantë atje. Pse ato nuk u larguan asnjëherë?! Sigurisht se bëhet fjalë për aspiratat nacional-shoviniste të Serbisë, arsyetimet banale për të cilat arrijnë të artikulojnë edhe përmes ca politikanëve të Kosovës, siç është rasti i Veton Surroit. Prandaj më e pakta që i dhamë ne atij dhe Petersenit gjatë njërit prej aksioneve tona të shumta ishte sana e mbledhur në pronat e shqiptarëve që gjenden brenda Zonës së

Veçantë të Manastirit të Deçanit, e të cilëve nuk po iu lejohet asnjë aktivitet tjetër përveç kositjes së barit.

Nga hartat dhe aerofotografitë që i kemi siguruar nga një nëpunës teknik i Ekipit Negociator të Kosovës për 15 nga gjithsej 39 këso zonash vërehet qartë se çfarë është bërë në negociata për trashëgiminë kulturore. Atëherë kur kishat e manastiret ortodokse në Kosovë janë ndodhur në vendbanimet me shumicë serbe, oferta e palës kosovare përputhet me kërkesën e Serbisë, që do të thotë se negociatorët kosovar i kanë dhënë Serbisë aq sa ajo ka kërkuar! Atëherë kur objektet fetare ortodokse janë ndodhur në vende malore e kodrinore ose afër tyre, territoret që kanë marrur ato janë shumë më të mëdha, gjithmonë më shumë se 200 hektarë, pasi që Serbia don që të kontrollojnë pikat e larta që kanë rëndësi strategjike e ushtarake. Ndërkaq, në fusha e vende të rrafshta, 'eksterritorialiteti' është më i vogël territorialisht, por në ato raste janë kujdesur që të fusin sa më shumë rrugë dhe udhëkryqe brenda zonës së veçantë në mënyrë që të mund të bllokojnë qarkullimin sa herë duan.

Fakti më skandaloz që tregon se krijimi i Zonave të Veçanta është një veprim politik i Beogradit që s'ka lidhje, madje, as me trashëgimi kulturore është kërkesa e tyre që një hapësirë e tillë e mbrojtur të krijohet edhe për përmendoren e Betejës së Kosovës në Gazimestan. Kjo përmendore konsiderohet prej Beogradit si objekt i trashëgimisë kulturore, kurse ai është ndërtuar në vitin 1953! Kërkesën e Serbisë për krijimin e kësaj zone e pranoi Grupi Negociator i Kosovës. Në foton 14 mund të shihet kjo zonë për të cilën u morën vesh palët në negociata.

Njëjtë sikurse nëpërmjet decentralizimit, këto Zona të Veçanta kanë për qëllim marrjen e pikave kodrinoro-malore me rëndësi të madhe strategjike ushtarake. Jorastësisht aty ku këto zona gjenden në vendet malore, hapësira që ato po marrin është shumëfish më e madhe se sa në zonat të cilat gjenden në vende të rrafshëta. Ato zona që gjenden rrëzë ndonjë pike malore, atyre po iu jepet zakonisht edhe faqja e prapme e malit. Kjo nuk shpjegohet ndryshe përpos me terma të strategjisë ushtarake. Në foton 15 mund të shihet qartë kjo gjë.

Që e keqja të përjetësohet vërtet, po u implementuan Zonat e Veçanta

VETËVENDOSJE !

përreth objekteve ortodokse ato do të mund të marrin edhe shumë hapësira përbrenda qyteteve, gjë që do t'i ndajë vendet tona urbane. Një gjë e tillë mund t'i ndodh qytetit të Lypjanit. Manastirit i cili gjendet në qytet janë pajtuar t'i jepet Zona e Veçantë. Në këtë mënyrë, Lypjani mund të bëhet Mitrovica e ardhshme (shih foton 16). Po ashtu, njërin prej pjesëve më të bukura të periferisë së qytetit të Prizrenit Grupi Negociator është pajtuar t'ia japë zonës së veçantë përreth Manastirit që gjendet atje (shih foton 17). E njëjta gjë i kanoset edhe Pejës (foto 18). Kurse me krijimin e Zonës së Veçantë të manastirit të Graçanicës do të bllokoheshin të tri udhëkryqet e rëndësishme që lidhin rajonin e Anamoravës me Rrafshin e Kosovës (foto 19). Zonat e Veçanta, bile, do të mund të shkaktojnë uzurpimin e asaj që është trashëgimi kulturore e Kosovës. Manastiri i Sokolicës, p.sh., përfshin përbrenda Kullën e Isa Boletinit.

Në manastiret të cilat ndodhen në vendbanimet me shumicë serbe, oferta e Grupit Negociator të Kosovës përputhet me propozimin e UNOSEC-ut (praktikisht me kompromisin), që do të thotë se përputhet me kërkesën e Serbisë për kufijtë e Zonave të Veçanta.

Në fillim Grupi Negociator i Kosovës tha që nuk do të krijonin asnjë Zonë të Veçantë. Më pas ata u pajtuan që vetëm Manastirit të Deçanit t'i jepet Zona e Veçantë. Përgjatë negociatave Grupi Negociator i Kosovës u pajtua që numrin e Zonave të Veçanta ta rrisë në 8. Lëshimi pe vazhdoi: në takimin e tretë - 13; në të katërtin - 15; kurse në takimin e fundit, pala e Kosovës u pajtua që të krijohen 39 të tilla! Ky nuk është, madje, as kompromis, meqë Serbia kërkonte gjithsej 42 Zona të Veçanta. Shih tabelën 20.

Gjithçka e qartë: nëpërmjet Zonave të Veçanta përreth objekteve fetare dhe decentralizimit Serbia po synon copëtimin e Kosovës. Këto dy projekte të rrezikut kapital po i japin Beogradit forcën e kushtëzimit absolut për të ardhmen e Kosovës. Decentralizimi dhe krijimi i këtyre hapësirave me status të veçantë e bëjnë Kosovën hapësirë politike jofunkionale. Nëpërmjet këtyre planeve Beogradi fuqizohet aq sa të bëhet arbitër i pengimit të funksionimit politik të vendit tonë. Ato janë investim i qëndrueshëm në kushtet që çmimi i çfarëdo shkëputjeje nga Serbia të jetë humbja e rreth 40% të territorit të vendit.

Këto dy projekte duhet të ndalen me çfarëdo çmimi që ato kërkojnë. Kosovës i duhet vetëvendosja. Ajo e parandalon copëtimin dhe rikolonizimin e vendit.

SPOMENICI KULTURE SRBIJE STRATEŠKOG ZNAČAJA
NA KOSOVU I METOHIJI



Foto 8: Harta me objektet ortodokse strategjike dhe jostrategjike sipas Qendrës Koordinuese të Serbisë për Kosovën. Me të kaltra, objektet e padëmtuara. Me të kuqe, objektet e dëmtuara gjatë vitit 1999. Me rreth të kuq objektet e dëmtuara gjatë marsit të vitit 2004.



Foto 9: Manastiri i Deçanit para një shekulli. Përreth mund të shquhen shqiptarët me veshje kombëtare.



Foto 10: Këshilli kishtar i Manastirit të Deçanit në vitin 1895. Shqiptarët me veshje kombëtare rreth priftit ortodoks. Pra, shqiptarët ishin ata që për shekuj me radhë jo vetëm që frekuentuan këto objekte, por, madje, edhe i ruajtën e mbrojtën ato.



Foto 11: Afreskë nga Patrikana e Pejës. Mund të shihen shqiptarët me plisa.




Foto 12: Afreskë nga Kisha e Apostujve. Varrimi i Peshkopit Sava II. Viti 1633/34. Në rendin e dytë duken persona me plisa.




Foto 13. Zona afër njëmijëhektarëshe e cila iu dhurua Manastirit të Deçanit nga Grupi Negociator i Kosovës në negociata me Serbinë.




Foto 14: Zona e veçantë që Grupi Negociator i Kosovës u pajtua u pajtua të krijohet përreth përmendores së Betejës së Kosovës në Gazimestan. Më 28 qershor të vitit 1989 Slobodan Milosheviqi shpalosi projektin e tij politik antishqiptar.



Foto 15: Zona e veçantë përreth Manastirit të Shën Arhangjelit, afër qytetit të Prizrenit.




Foto 16: Zona e veçantë përreth Kishës në qytetin e Lypljanit për të cilën Grupi Negociator është pajtuar me Beogradin. Siç mund të vërehet, kjo zonë e ndan qytetin përgjysmë. Ajo krijon kushtet për një konflikt të përhershëm.




Foto 17: Zona përreth Manastirit në periferi të Prizrenit.




Foto 18: Zona e Veçantë e Patrikanës së Pejës në dalje të qytetit të Pejës




Foto 19: Zona e Veçantë përreth Manastirit të Graçanicës

Serbia	GN i Kosovës	<i>Tabela 20. Historiku i dhurimit të zonave të veçanta nga Grupi Negociator i Kosovës në negociata me Beogradin.</i>
40	0	
40	1	
40	8	
40	13	
42	15	
42	39	